

# DITA BOTËRORE E MJEDISIT

## 5 QERSHOR - DITA BOTËRORE E MJEDISIT

### 3 – 7 qershor Java e ndërgjegjësimit për Mbrojtjen e Mjedisit

Qëllimi i kësaj dite dhe jave është që të realizohen aksione për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit human.

#### Si u vendos dita botërore e mjedisit?

Dita ndërkombëtare e mjedisit është caktuar mbi 30 vjet më parë nga Asambleja e përgjithshme e OKB-së, me qëllim për të shtuar vetëdijen rreth çështjeve të mjedisit dhe për të tërhequr vëmendjen politike ndaj këtyre çështjeve si dhe për të nxitur veprimin individual në këtë drejtim.

5 Qershori u caktua si Dita Botërore e Mjedisit në vitin 1972, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-s. U zgjodh kjo datë sepse përkon me ditën e hapjes e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin, që u mbajt në vitin 1972 në Stokholm, nën udhëheqjen e Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i kësaj ngjarje është të nxisë aktivitete dhe aksione për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit. Kjo dite zakonisht përcillet me një tematikë të caktuar. Në të kaluarën tema të kësaj ngjarje kanë qenë kujdesi për tokën dhe ujin, mbrojtja e shtresës së ozonit, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm duke patur gjithnjë në fokus ruajtjen e shëndetit human.

#### Pse ka rëndësi promovimi i shëndetit mjedisor?

Sipas studimeve të shumta të kryera në vite nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH):

- Në botë, 13 milion raste të vdekjeve mund të parandalohen duke patur çdo vit mjedise të shëndetshme.
- Tek fëmijët nën moshën pesë vjeç, një e treta e të gjithë sëmundjeve shkaktohet nga faktorë të tillë si : konsumi i ujit jo higjienikisht i pastër dhe ndotja e ajrit.
- Çdo vit, jeta e katër milion fëmijëve nën moshën 5 vjeç - kryesisht në vendet në zhvillim - mund të ruhet me anë të parandalimit të rreziqeve mjedisore të tilla si uji i pasigurt dhe ajrit i ndotur.

- Në vendet në zhvillim, sëmundjet kryesore të shkaktuara nga ndotja e mjedisit janë sëmundjet diarreike, infeksionet respiratore, malarja.
- Mirëmenaxhimi i mjedisit mund të parandalojë 40% të vdekjeve nga malaria, 41% të vdekjeve nga infeksionet respiratore, dhe 94% të vdekjeve nga sëmundjet diarreike.
- Në vendet e zhvilluara, një e treta e vdekjeve dhe e sëmundjeve janë të lidhura direkt me ndotjen e mjedisit.
- Në vendet e zhvilluara, mjediset e shëndetshme mund të zvogëlojnë ndjeshëm incidencën e kancerit, sëmundjeve kardiovaskulare, astmën, infeksionet e në rrugët e frymëmarrjes, sëmundjet e sistemit kockor e muskolor, etj.
- Sipas raportit botëror të shëndetit nga 102 kategoritë e sëmundjeve dhe lëndimeve të shënuara, 85 janë nga faktorët mjedisore.
- Pjesa më e madhe e vdekjeve, sëmundjeve dhe paaftësive mund të parandalohen duke ndërhyrë dhe synuar në promovimin mjediseve të sigurt si: mbajtja e higjienës, përdorimi i pastër dhe i sigurtë i karburanteve, etj.
- Ndërhyrje të tjera që mund të përfshijnë shëndetin mjedisor janë: rritja e sigurisë së ndërtesave, përdorimi i kujdesshëm dhe menaxhimi i substancave toksike në shtëpi dhe në vendin e punës; mirëmenaxhimi i burimeve të ujit.

### **Sa të rrezikuar jemi nga ndotja e mjedisit?**

Sipas “Raportit të Shëndetit Evropian (2009)”, në rajonin evropian, ndodhin më shumë se 1.7 milion vdekje në vit (ose 18% e të gjitha vdekjeve) për shkak të ndotjes së mjedisit.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) rezultohet se një e treta e gjithë sëmundshmërisë tek fëmijët dhe adoleshentët, në moshat 0-19 vjeç ndodh për shkak të faktorëve mjedisorë.

Ndotja e ajrit nga përdorimi i automjeteve të vjetra në disa qytete kryesore të Shqipërisë përbën më të vërtetë një problem shumë serioz. Sipas një raporti të publikuar në vitin 2012 nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Evropën, vetëm në qytetin e Tiranës, 500 vdekje në vit mund t’i atribuohen ndotjes së ajrit.